



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
**OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC**



**DREJTORIA E ARSIMIT**

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës , Nr.04/L-032 , Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.04/L-138,Udhëzimin Administrativ të MASHTI-it, me nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, dokumentin nga MASHTI,Nr.3/2497,datë 01.07.2025 dhe kërkesën me nr. 10-104-02-21186-25 datë 31.07.2025 ,Drejtoria për Arsim, më 19.08.2025, shpall :

**K O N K U R S P L O T Ë S U E S**  
**( Afati i gushtit )**

(Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Shkollën Profesionale Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional, IAAP) për vitin shkollor 2025-2026,apafiti i gushtit sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

**1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin "17 Shkurti" në Obiliq dhe SHMLP "Isamil Dumoshi" në Obiliq për vitin shkollor 2025-2026, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Republikës së Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e certifikatave ose dëftesave në MASHTI, pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

**2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në Gjimnaz dhe Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), duhet të paraqesin këto dokumente :

- Fletëparaqitjen (e cila do të merret në shkollën në të cilën konkurron )
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9 )
- Certifikatën e lindjes

**3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Dorëzimi i dokumenteve për gjimnaz dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2025/2026 , bëhet me datat: 19.20 dhe 21 gusht 2025, në lokalet e shkollës , ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen, duke filluar nga ora 08:00 -16:00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve do të shpallen në shkollat përkatëse me datën 22.08.2025

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 25.08.2025.  
Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa prashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhet në Drejtorinë e Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimin të përgjigjes nga shkolla.

### **A. Kriteret për regjistrim**

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere :

- |                                                           |               |
|-----------------------------------------------------------|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar                       | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi                               | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaz është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasët 6-9, pastaj, mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaz është minimum 40% i pikëve nga ato lëndë.

- Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl.6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë .

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6+kl.7+kl.8+kl.9) } \times 2 = 40 \text{ pikë maksimum}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë .

Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë maksimum

- **Lëndët me përparësi në sukses sipas drejtimeve të gjimnazit :**
  - a) Gjimnazi i shkencave natyrore : Fizikë, kimi, biologji dhe matematikë
  - b) Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi
- **Lëndët me përparësi në sukses sipas profileve në IAAP :**
  - c) **Elekteonikë, Xehtari, Kimi -teknologji dhe ,Gjeologji:** Matematikë, informatikë, fizikë, gjuhë shqipe dhe letërsi

**4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët me përparësi për drejtimet përkatëse**

- **Gjimnazi i shkencave natyrore:** Mesatarja e lëndëve fizikë, kimi ,biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si 40% të lëndëve prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\text{mesatarja (kimi )} + \text{mes.biologji} + \text{mes.fizikë} + \text{mes . matematikë} \geq 4$$

4

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore :** Mesatarja e lëndëve gjuhë shqipe, gjuhë angleze, hystori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 ( katër) si 40% të lëndëve prioritare në test (20 pikë nga lëndët: gjuhë shqipe, gjuhë anfleze hystori dhe gjeografi )

$$\text{Mes. (gjuhë shqipe )} + \text{mes.( gjuhë angleze)} + \text{mes.(hystori )} + \text{mes .gjeografi} \geq 4$$

4

**B. Pëmbajtja e testit: numri i kërkesave (pytjeve) sipas lëndëve**

**I.Gjuhë:**

- |                    |         |
|--------------------|---------|
| 1. Gjuhë shqipe    | 25 pikë |
| 2. Gjuhë angleze   | 5 pikë  |
| (Gjithsej 25 pikë) |         |

**II.Shkencat shoqërore:**

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1. Gjeografi         | 12 pikë |
| 2. Hystori           | 13 pikë |
| ( Gjithsej 25 pikë ) |         |

**III:Matematikë dhe informatikë**

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1. Matematikë        | 20 pikë |
| 2. Informatikë       | 5 pikë  |
| ( Gjithsej 25 pikë ) |         |

**IV.Shkencat natyrore:**

- |                      |        |
|----------------------|--------|
| 1. Fizikë            | 8 pikë |
| 2. Kimi              | 8 pikë |
| 3. Biologji          | 9 pikë |
| ( Gjithsej 25 pikë ) |        |

**5. Renditja e lëndëve me prioritetet sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

**I. Gjimnazi shkencat e natyrës:**

- |                                           |                       |
|-------------------------------------------|-----------------------|
| 1. Shkencat e natyrës 25 .....            | 25x0.8=20 pikë        |
| 2. Matematikë informatikë 25.....         | 25x0.4=10 pikë        |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25..... | 25x0.3=7.5 pikë       |
| 4. Shkencat shoqërore 25.....             | <u>25x0.1=2.5pikë</u> |
| <b>Totali 40 pikë</b>                     |                       |

**II. Gjimnazi shoqëror :**

- |                                           |                        |
|-------------------------------------------|------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore 25.....             | 25x0.6=15 pikë         |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25..... | 25x0.6=15 pikë         |
| 3. Matematikë informatikë 25.....         | 25x0.3=7.5 pikë        |
| 4. Shkencat natyrore 25.....              | <u>25x0.1=2.5 pikë</u> |
| <b>Totali 40 pikë</b>                     |                        |

**6. Rënditja e lëndëve me prioritetet sipas profileve në shkollën profesionale**

**I. Informatikë, energjetikë, instalues elektrik dhe xehtari**

- |                                           |                        |
|-------------------------------------------|------------------------|
| 1. Matematikë dhe informatikë 25 .....    | 25x0.8=20 pikë         |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25..... | 25x0.4=10 pikë         |
| 3. Shkencat natyrore 25.....              | 25x0.3=7.5 pikë        |
| 4. Shkencat shoqërore 25.....             | <u>25x0.1=2.5 pikë</u> |
| <b>Totali 40 pikë</b>                     |                        |

**II. Ekonomi (Kontabilist e Banka dhe Sigurime)**

- |                                        |                        |
|----------------------------------------|------------------------|
| 1. Matematikë dhe informatikë 25.....  | 25 x 0.8=20 pikë       |
| 2. Gjuhë amtare, gjuhë angleze 25..... | 25 x 0.4=10 pikë       |
| 3. Shkencat shoqërore 25.....          | 25 x 0.3=7.5 pikë      |
| 4. Shkencat natyrore 25.....           | <u>25x0.1=2.5 pikë</u> |
| <b>Totali 40 pikë</b>                  |                        |

## Gjimnazi “ 17 Shkurti “ në Obiliq

| Nr.       | Drejtimi          | Numri i paraleleve të planifikuara | Numri i nxënësve në afatin e gushtit |
|-----------|-------------------|------------------------------------|--------------------------------------|
| 1.        | Gjimnazi Natyror  | 2                                  | 39                                   |
| 2.        | Gjimnazi shoqëror | 2                                  | 30                                   |
| Gjithsej: |                   | 4                                  | 69                                   |

## SHMLP“ Ismail Dumoshi“ në Obiliq

| Nr.      | Drejtimi                                   | Profili            | Nr.i paraleleve të planifikuara | Nr.i Nxënësve në afatin e gushtit |
|----------|--------------------------------------------|--------------------|---------------------------------|-----------------------------------|
| 1.       | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Informatikë        | 1                               | 6                                 |
|          | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Energjetikë        | 1                               |                                   |
|          | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Instalues elektrik | 1                               | 12                                |
| 2.       | Kimi-teknologji                            | Xehtari            | 1                               |                                   |
| 3.       | Ekonomi, administrim dhe juridik           | Kontabilist        | 1                               | 15                                |
|          |                                            | Banka dhe sigurime | 1                               | 12                                |
| Gjithsej |                                            |                    | 6                               | 45                                |

Drejtoresha e DA-së: Fitore Hashani

